VENDIM
Nr. 230, datë 18.8.2026

MBI MIRATIMIN E "RREGULLAVE PËR REGJISTRIMIN NË ERE TË IMPIANTEVE TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE GJATË REGJIMIT KALIMTAR"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 51, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.8.2026, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës me nr. 2383/2 prot., datë 14.8.2026, "Mbi miratimin e rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Ligji nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", ka përcaktuar një kuadër të ri ligjor për depozitimin e energjisë elektrike, duke rregulluar edhe trajtimin e impianteve të depozitimit që ekzistojnë në momentin e hyrjes së tij në fuqi. Në mënyrë të posaçme, neni 51 parashikon kushtet në të cilat impiantet e depozitimit të energjisë elektrike, që në datën e hyrjes në fuqi të ligjit janë në zhvillim ose në operim, njihen si të tilla, duke i përfshirë ato në regjimin kalimtar të përcaktuar nga kjo dispozitë. Ky parashikim siguron trajtimin e këtyre impianteve, në kuadër të regjimit të ri ligjor, duke marrë në konsideratë statusin e tyre në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit.
- Neni 51, i ligjit nr. 59/2026, përcakton regjimin e zbatueshëm për impiantet e depozitimit të energjisë elektrike që, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, ndodhen në zhvillim ose në operim, si dhe detyrimet përkatëse të subjekteve që përfshihen në këtë regjim. Në zbatim të kësaj dispozite, subjektet përkatëse duhet të njoftojnë dhe të regjistrojnë pranë ERE-s impiantet e depozitimit që përfshihen në fushën e zbatimit të saj, brenda afatit të përcaktuar në ligj.
- Për zbatimin e këtij detyrimi është i nevojshëm përcaktimi i një mënyre të njëtrajtshme për paraqitjen, administrimin dhe evidentimin e informacionit, lidhur me subjektet dhe impiantet e depozitimit që përfshihen në regjimin kalimtar të nenit 51, të ligjit nr. 59/2026.
- Rregullat përcaktojnë mënyrën e njoftimit dhe regjistrimit pranë ERE-s, informacionin që duhet të paraqitet nga subjektet, mënyrën e administrimit të tij nga ERE, si dhe përditësimin e të dhënave të regjistruara.
- Në rastet kur informacioni dhe dokumentacioni për një impiant ose njësi depozitimi është administruar më parë pranë ERE-s, në kuadër të një procedure licencimi, modifikimi licence apo procedure tjetër administrative, rregullat mundësojnë marrjen në konsideratë të këtij informacioni, duke shmangur kërkimin dhe riparaqitjen e të njëjtit dokumentacion, për sa kohë ai vazhdon të jetë i vlefshëm dhe të dhënat përkatëse nuk kanë ndryshuar.
- Për administrimin e njëtrajtshëm të procesit të regjistrimit janë përgatitur Formulari i Regjistrimit të Impiantit të Depozitimit të Energjisë Elektrike, Fleta Individuale e Regjistrimit dhe Regjistri i Impianteve të Depozitimit të Energjisë Elektrike.
- Regjistrimi sipas nenit 51, të ligjit nr. 59/2026, ka karakter evidentues për qëllimet e zbatimit të regjimit kalimtar dhe nuk përbën licencë për ushtrimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike dhe as nuk paragjykon vlerësimin e ERE-s në procedurat e licencimit, kur ky licencim kërkohet sipas ligjit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë "Rregullat për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë aneksin nr. 1 "Formulari i regjistrimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike",

aneksin nr. 2 “Fleta individuale e regjistrimit”, aneksin nr. 3 “Regjistri i impianteve të depozitimit të energjisë elektrike”, të cilët janë pjesë përbërëse e rregullave të miratuara sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Formulari i regjistrimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike dhe fleta individuale e regjistrimit publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe janë të disponueshme për subjektet e interesuara.

4. Regjistri i impianteve të depozitimit të energjisë elektrike administrohet dhe përditësohet nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës. Të dhënat e regjistrit bëhen publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin konfidencial.

5. “Afati për njoftimin dhe regjistrimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLAT PËR REGJISTRIMIN NË ERE TË IMPIANTEVE TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE GJATË REGJIMIT KALIMTAR

Neni 1
Qëllimi

Këto rregulla përcaktojnë mënyrën e njoftimit dhe regjistrimit pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike që përfshihen në regjimin kalimtar të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 2
Zbatimi

Detyrimi për regjistrim zbatohet për personat fizikë ose juridikë që, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 59/2026, kanë në zhvillim ose në operim një impiant depozitimi të energjisë elektrike, në kushtet e përcaktuara nga neni 51, pika 3 e ligjit.

Neni 3
Afati

Subjektet sipas nenit 2 duhet të njoftojnë ERE-n dhe të paraqesin të dhënat për regjistrimin e impiantit brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 59/2026, në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 51, pika 5 të tij.

Neni 4
Mënyra e regjistrimit

1. Për regjistrimin e impiantit, subjekti plotëson Formularin e Regjistrimit, bashkëlidhur këtyre rregullave, dhe e paraqet atë pranë ERE-s në formë shkresore ose elektronike.

2. Formulari përmban të dhënat e nevojshme për identifikimin e subjektit dhe të impiantit, përfshirë statusin e tij, vendndodhjen, fuqinë, kapacitetin e depozitimit, teknologjinë e përdorur dhe, sipas rastit, të dhënat për lidhjen me rrjetin.

3. Subjekti paraqet informacionin ose dokumentacionin që provon se impianti përfshihet në kushtet e regjimit kalimtar të përcaktuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026.

Neni 5

Regjistrimi i impianteve të deklaruara më parë pranë ERE-s

1. Për subjektet që, përpara hyrjes në fuqi të këtyre rregullave, kanë njoftuar ose kanë paraqitur pranë ERE-s të dhëna për një impiant apo njësi të depozitimit të energjisë elektrike, në kuadër të një aplikimi për licencim, ndryshim ose modifikim licence, apo në kuadër të një procedure administrative të filluar nga ERE, informacioni dhe dokumentacioni i administruar në dosjen përkatëse merret në konsideratë për qëllime të regjistrimit sipas nenit 51, të ligjit nr. 59/2026.

2. Kjo zbatohet edhe për rastet kur njësia e depozitimit është paraqitur si pjesë e projektit energjetik, përfshirë rastet kur është identifikuar si vepër ndihmëse, njësi depozitimi e integruar ose pjesë funksionale e impiantit të prodhimit të energjisë elektrike.

3. Kur nga dokumentacioni i administruar pranë ERE-s rezultojnë të dhënat e nevojshme për identifikimin e subjektit dhe të njësisë së depozitimit, ERE kryen regjistrimin mbi bazën e dokumentacionit ekzistues, pa kërkuar riparaqitjen e të njëjtit informacion.

4. Për subjektet për të cilat Bordi i ERE-s ka filluar ose ka përfunduar një procedurë licencimi apo modifikimi licence dhe në dokumentacionin e miratuar ose të administruar rezulton përfshirja e një njësie depozitimi, ERE pasqyron këtë njësi në regjistrin përkatës.

5. Regjistrimi sipas kësaj pike nuk ndryshon efektet juridike të vendimeve të mëparshme të ERE-s dhe nuk paragjykon nevojën për licencim, modifikim licence apo përmbushjen e detyrimeve të tjera të parashikuara nga ligji nr. 59/2026.

Neni 6

Shqyrtimi dhe vendimmarrja për regjistrimin

1. Struktura përgjegjëse e ERE-s, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga paraqitja e Formularit të Regjistrimit dhe dokumentacionit shoqërues, shqyrton plotësinë e tyre dhe verifikon nëse janë paraqitur të dhënat dhe dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e impiantit sipas këtyre rregullave.

2. Kur konstatohet se informacioni ose dokumentacioni i paraqitur është i paplotë, ERE, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, i kërkon subjektit plotësimin ose sqarimin e tij. Subjekti duhet të paraqesë informacionin ose dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit të ERE-s.

3. Në rast se subjekti nuk paraqet informacionin ose dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, ERE vijon shqyrtimin mbi bazën e dokumentacionit të administruar dhe vlerëson nëse ai është i mjaftueshëm për regjistrimin sipas nenit 51, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

4. Kur dokumentacioni rezulton i plotë, struktura përgjegjëse përgatit relacionin përkatës dhe i propozon Bordit të ERE-së regjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.

5. Bordi i ERE-s merr vendim për regjistrimin ose mosregjistrimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data kur dokumentacioni konsiderohet i plotë ose nga data kur përfundon afati sipas pikës 2 të këtij neni.

6. Për qëllime të pikës 5 të këtij neni, dokumentacioni konsiderohet i plotë në datën e paraqitjes së Formularit të Regjistrimit, kur ERE nuk konstaton nevojën për plotësime ose sqarime, ose në datën e

depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit plotësues të kërkuar nga ERE. Në rast se plotësimet ose sqarimet e kërkuara nuk paraqiten brenda afatit të përcaktuar, procedura vijon mbi bazën e dokumentacionit të administruar dhe afati për vendimmarrjen e Bordit fillon nga dita pas përfundimit të afatit të dhënë për plotësim.

7. Pas marrjes së vendimit për regjistrimin, impianti pasqyrohet në Regjistrin e Impianteve të Depozitimit të Energjisë Elektrike dhe pajiset me numrin përkatës të regjistrimit.

8. ERE njofton subjektin për vendimin e Bordit dhe i përcjell Fletën Individuale të Regjistrimit.

Neni 7
Përditësimi i të dhënave

Subjekti njofton ERE-n për ndryshimet e mëvonshme të të dhënave të regjistruara që lidhen me identifikimin ose statusin e impiantit. ERE pasqyron ndryshimet në evidencën përkatëse.

Neni 8
Efekti i regjistrimit

Regjistrimi sipas këtyre rregullave kryhet për qëllimet e zbatimit të nenit 51, të ligjit nr. 59/2026, dhe nuk përbën licencë për ushtrimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike. Këto subjekte do të lejohen të operojnë sipas licencës ekzistuese për një periudhë jo më shumë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 59/2026.

Regjistrimi nuk paragjykon vlerësimin e ERE-s në procedurën e mëvonshme të licencimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 59/2026.

Neni 9
Anekset

Aneksi nr. 1 “Formulari i regjistrimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike”, aneksi nr. 2 “Fleta individuale e regjistrimit” dhe aneksi nr. 3 “Regjistri i impianteve të depozitimit të energjisë elektrike” janë pjesë përbërëse e këtyre rregullave.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Këto rregulla hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare, dhe janë objekt rishikimi me vendim të ERE-s.

ANEKS NR. 1

FORMULARI I REGJISTRIMIT TË IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
(Mbahet në zbatim të nenit 51, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”)

I. TË DHËNAT E SUBJEKTIT
Emri/emërtimi i subjektit:

_____

NUIS/NIPT:

_____

Forma juridike:

_____

Adresa e selisë:

Përfaqësuesi ligjor:

Telefon: _____
Email: _____
Personi i kontaktit:

II. TË DHËNAT E IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT
Emërtimi i impiantit/projektit:

Vendndodhja:
Njësia administrative/bashkia/ qarku/etj.

Koordinatat gjeografike: (shënime të tjera plotësuese nëse ka mbi vendndodhjen)

Statusi i impiantit në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 59/2026:
☐ Në zhvillim
☐ Në operim
Data e pritshme fillimit të zhvillimit/operimit:

III. TË DHËNAT KRYESORE TEKNIKE
Teknologjia e njësisë së depozitimit:

Fuqia nominale e ngarkimit (mw):

Fuqia nominale e shkarkimit (mw):

Kapaciteti energjetik i depozitimit (MWh):

Operatori i sistemit ku/do të lidhet impianti, sipas rastit:
☐ OST sh.a.
☐ OSSH sh.a.

Pika e lidhjes me rrjetin (statusi aktual):

IV. MARRËDHËNIA ME IMPIANTIN/PROJEKTIN KRYESOR

Njësia e depozitimit është:

☐ Impiant i pavarur depozitimi

☐ E parashikuar si vepër ndihmëse e projektit apo si njësi depozitimi e integruar me impiantin e prodhimit

☐ Tjetër:

Në rast se njësia e depozitimit është e integruar me një impiant prodhimi apo e parashikuar si vepër ndihmëse:

Emërtimi i impiantit prodhues të energjisë elektrike:

Lloji i burimit:

☐ Fotovoltaik;

☐ Eolik;

☐ Hidrik;

☐ Tjetër: _____.

Fuqia e instaluar e impiantit prodhues të energjisë elektrike (mw):

V. INFORMACIONI I ADMINISTRUAR MË PARË PRANË ERE-S

A është impianti/njësia e depozitimit deklaruar më parë pranë ERE-s?

☐ Po

☐ Jo

Nëse po, përcaktoni procedurën:

☐ Aplikim për licencim;

☐ Aplikim për modifikim licence;

☐ Tjetër:

Nr. i licencës ekzistuese: _____

Në rast se informacioni dhe dokumentacioni për njësinë e depozitimit është administruar më parë pranë ERE-s, subjekti nuk është i detyruar ta riparaqesë atë, për sa kohë të dhënat përkatëse nuk kanë ndryshuar dhe vazhdojnë të jenë të vlefshme.

VI. DOKUMENTACIONI/INFORMACIONI SHOQËRUES

Bashkëlidhen, sipas rastit:

☐ Dokumentacioni që provon se impianti/njësia e depozitimit ishte në zhvillim ose operim në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 59/2026.

☐ Dokumentacioni teknik bazë i njësisë së depozitimit.

☐ Dokumentacioni mbi lidhjen me rrjetin, nëse disponohet.

☐ Dokumentacioni që evidenton integrimin e njësisë së depozitimit në impiantin e prodhimit.

☐ Dokumentacioni i përditësuar, në rast se të dhënat e administruara më parë nga ERE kanë ndryshuar.

Përveç sa më sipër, subjektet me statusin në zhvillim, do të depozitojnë:

- Informacion mbi mënyrën e financimit të projektit;
- Plan biznesi për zhvillimin e këtij projekti.

Përveç sa më sipër, subjektet me statusin në operim të njësisë së depozitimit, do të depozitojnë:

☐ Leje, autorizime dhe çdo dokument që disponohet për ndërtimin dhe operimin e njësisë së depozitimit.

VII. DEKLARATA

Deklaroj se të dhënat dhe informacioni i paraqitur në këtë formular janë të sakta dhe pasqyrojnë gjendjen faktike të impiantit/njësisë së depozitimit të energjisë elektrike.

Deklaroj se:

☐ informacioni dhe dokumentacioni i administruar më parë pranë ERE-s nuk kanë ndryshuar dhe vazhdojnë të jenë të vlefshme;

ose

☐ pas administrimit të tyre pranë ERE-s kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme:

_____

_____

Marr përsipër të njoftoj ERE-n për çdo ndryshim të mëvonshëm të mundshëm të të dhënave të regjistruara.

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor:

_____

Data: _____. _____._____

Nënshkrimi:

_____

_____

ANEKS 2

FLETË INDIVIDUALE REGJISTRIMI

(Mbahet nga ERE – kopje e këtij formulari i jepet aplikuesit në përfundim të regjistrimit)
Data e njoftimit: _____
Data e dokumentacionit plotësues (nëse ka pasur): _____
Nr. unik i regjistrimit: ERE/DEP/ XXXX /0X)
(ku: ERE – Enti Rregullator i Energjisë; DEP – depozitimi i energjisë elektrike; XXXX – viti i regjistrimit; 0X – numri rendor progresiv i regjistrimit).

Data e regjistrimit: _/_/_____ (data, muaji, viti)
Subjekti: _____
NUIS/NIPT: _____

Impianti/projekti:

_____
_____
_____
_____
_____

Vendndodhja:

Statusi në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 59/2026:
Në zhvillim/në operim

Klasifikimi i njësisë së depozitimit:
Impiant i pavarur/pjesë e impiantit të prodhimit/njësi e integruar/vepër ndihmëse/tjetër.
Të dhënat teknike:
Fuqia e ngarkimit: _____mw
Fuqia e shkarkimit: _____mw
Kapaciteti energjetik: _____mwh
Teknologjia:

Lidhja me rrjetin:
OST sh.a./OSSH sh.a.
Pika e lidhjes: _____
Impianti prodhues, kur aplikohet:
Emërtimi:

Burimi: PV/eolik/hidrik/tjetër
Fuqia e instaluar: _____mw
Baza dokumentare e regjistrimit:

Formulari nr. _____, datë ___.___._____

Shënime të tjera: _____

Nënshkrimi i titullarit të ERE-s

Mbas nënshkrimit nga titullari, fleta individuale e regjistrimit dorëzohet në arkivin e institucionit dhe kopje e saj i dërgohet aplikuesit.

ANEKS NR. 3

REGJISTRI I IMPIANTEVE TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(Administrohet nga ERE në zbatim të nenit 51, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike")

Nr. i regjistrimi	Subjekti	NUIS/ NIPT	Emërtimi i impiantit/ projektit	Statusi i impiantit	Lloji i impiantit të depozitimit	Fuqia (mw)	Vendndodhja	Licenca ekzistuese	Shënime

Shënime.

1. Çdo impiant ose njësi depozitimi regjistrohet me një numër individual sipas formatit: ERE/DEP/VITI/NR. RENDOR.
2. Në kolonën "Statusi i impiantit" pasqyrohet, sipas rastit: "Në zhvillim", ose "Në operim".
3. Në kolonën "Lloji i impiantit të depozitimit" pasqyrohet nëse impianti është i pavarur ose i integruar me një impiant prodhimi të energjisë elektrike.
4. Kur njësia e depozitimit është e integruar me një impiant prodhimi, në kolonën "Impianti kryesor" shënohet emërtimi dhe, sipas rastit, lloji i burimit të energjisë.
5. Ndryshimet e mëvonshme të të dhënave pasqyrohen në regjistër, pa ndryshuar numrin fillestar të regjistrimit.
6. Regjistrimi në këtë regjistër kryhet për qëllimet e zbatimit të nenit 51, të ligjit nr. 59/2026 dhe nuk përbën licencë për ushtrimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike.